



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:206613
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05802704

P.nr.2023:206613

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E.H, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.861/23 të dt. 19.09.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt. 23.05.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Azem Islamaj, i akuzuari E.H si dhe i dëmtuari L.Z, me dt. 28.05.2024, shpallë, ndërsa me dt.10.06.2024, e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: E.H, nga i ati S dhe e ëma S e lindjes N, i lindur më datën ..., në Malishevë ku edhe jeton, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas R së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datë 11.06.2023 rreth orës 19:00/h në Rahovec, me qëllim që vetit t'i sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme ia merr tjetrit pasurinë e luajtshme dhe atë të dëmtuarit L.Z, në atë mënyrë që ditën kritike pasi pandehuri ishte duke punuar tek i dëmtuari dhe me të përfunduar punën, i dëmtuari kërkon nga i pandehuri E që ti ruan ato sende gjegjësisht lodra për fëmijë dhe për të pushuar i'a lenë kamionin e tij, ashtu që i pandehuri duke shfrytëzuar momentin derisa nuk ishte askush prezent, e merr një unazë dhe të holla 20 euro në kamion dhe largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush, e më pas unazën e shet në argjendarinë „G” në vlerë prej 200 euro, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 520 Euro.

- me këtë ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69 dhe nenit 313 par.1 të KPRK-së si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjtit i:

G J Y K O N

Me dënimin me gjobë në shumë prej njëqind (100) euro, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në xhironlogarinë e kësaj gjykate në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, - si dhe me dënimin me kusht kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve burgim, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1(një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

I dëmtuari L.Z për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej njëzet euro (20€), në emër të viktimave të krimit shumën prej njëzet euro (20€) euro, ndërsa shpenzime të procedurës nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.861/23 të dt. 19.09.2023, e ka akuzuar E.H n, për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 23.05.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Azem Islamaj, i akuzuari E.H si dhe i dëmtuari L.Z, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari E.H, në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, të dëmtuarit Lirimit i kërkoj falje, me të dëmtuarin i kam raportet e mira, e di që kam gabuar, kërkoj nga gjykata pasi që i kam kushtet e vështira ekonomike, të më shqiptoj një dënim sa më të butë, ku i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që mos të kryej kurrfarë vepre penale.

I dëmtuari L.Z në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, nuk i bashkangjitem ndjekjes penale po ashtu nuk parashtoj kërkesë pasurore juridike pasi që menjëherë me ka kompensuar dënim dhe me ka kërkuar falje.

Prokurori i Shtetit Azem Islamaj ka deklaruar: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari pranimin e fajësisë e bëri ne vullnet të plotë, pa presion dhe pa shtytje nga askush, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe ii akuzuari të shpallet fajtores, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari E.H ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë;

- Raporti i oficerit M.K, datë 14.06.2023;
- Deklarata e të dëmtuarit L.Z, e dhënë në polici me dt.14.06.2023;
- Deklarata e të pandehurit E.H, e dhënë në polici me dt.16.06.2023;
- Një letër konfirmim se sa gram ka qenë unaza dhe vlerën sa e ka shitur;
- Si dhe shkresat tjera në lëndë

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 313 par.1 të KPRK-së parashihet: „Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”.

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin E.H, e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilat ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes nga neni 313 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr. 06/L074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, kushtet e dobëta ekonomike, është mbajtës i familjes prej 3 anëtarësh asnjëri i punësuar, punon si punëtor krahu kohë pas kohe kur gjen, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë veprë penale, të dëmtuarit i ka kërkuar falje, i dëmturi nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, dhe ka deklaruar se i akuzuari ia ka kompensuar dëmin, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumë prej njëqind euro (100) të cilin shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej **një (1) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

I dëmtuari L.Z nuk është udhëzuar në kontestin civil pasi që i njëjti nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449, par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39, parg.3 nënpar.3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.2023:206613 dt.28.05.2024.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.